




Breaking News:

Drejtoria Vendore e Policisë Berat, gjatë 24 orëve të fundit

⏏ ⏪ ⏩





Lajmet

Operacionet

07/04/2025

Delyinë – Finalizohet Operacioni Policor I Koduar “Sunrise”

Delvinë/Vijon goditja e armëmbajtjes pa leje, finalizohet me sukses nga Komisariati i Policisë Delvinë, operacioni policor i koduar “Sunrise”.

Sekuestrohen 1 armë zjarri kallashnikov, 1 armë gjahu çifte, krehra dhe municion.

Në pranga poseduesi, i cili i mbante të fshehura në banesë.

Në vijim të punës për parandalimin, evidentimin dhe goditjen e rasteve të armëmbajtjes pa leje, si dhe bazuar në informacionet e siguruara nga intelijenca informative, të cilat bënin me dije se një shtetas posedonte armë në banesën e tij, shërbimet e Komisariatit të Policisë Delvinë organizuan dhe finalizuan me sukses, gjatë paradites së sotme, operacionin policor të koduar “Sunrise”.

Si rezultat i këtij operacioni, u arrestua në flagrancë shtetasi L. T., 47 vjeç, banues në Delvinë.

Gjatë operacionit, shërbimet e Policisë ushtruan kontroll në banesën e shtetasit L. T., ku gjatë kontrollit gjetën dhe sekuestruan në cilësinë e provës materiale: 1 armë zjarri automatike tip kallashnikov, 1 armë gjahu çifte, 1 krehër kallashnikov, 2 krehra pistolete dhe një sasi fishekësh.

Materialet procedurale në ngarkim të këtij shtetasi i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, për veprime të mëtejshme hetimore dhe procedurale.

Kërko

Enter a word for search

🔍

Komisariati Dixhital

GET IT ON

Google Play

Download on the App Store

Arkiva

Select Month

▾

Linqe

> Arkiva

> Akademia e Sigurisë

> Ministria e Brendshme

> Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

> Interpol

> Europol

> Misioni PAMECA V

> SCPA

> Projekti Trivalent

◀ Drejtoria Vendore e Policisë Korçë, gjatë 24 orëve të fundit

Raporti i ngjarjeve, 5,6,7 prill 2025 ▶

Copyright © 2025 Policia e Shtetit. All rights reserved. Theme: ColorNews by ThemeGrill. Powered by WordPress.